



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, si dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **28 korrik 2022**, merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E KËSHILLAVE
LOKALE

1. Me këtë vendim themelohet komisioni për koordinimin e procesit për përzgjedhjen e këshillave lokale në këtë përbërje:

- 1.1 Blerina Shala, anëtare e Kuvendit të komunës;
- 1.2 Agron Përçuku, anëtar i Kuvendit të komunës;
- 1.3 Ymer Haradinaj anëtar i Kuvendit të komunës;
- 1.4 Bekim Zabergja, anëtar i Kuvendit të komunës;
- 1.5 Qemajl Hasani, anëtar i ekzekutivit të komunës;
- 1.6 Isak Hyseni, anëtar i shoqërisë civile, dhe
- 1.7 _____, përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane.

2. Komisioni komunal për përzgjedhjen e këshillave lokale do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane.

3. Mandati i Komisionit komunal për përzgjedhjen e këshillave lokale është i lidhur me mandatin e Kuvendit komunal.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit